



UNIVERSITETI - UNIVERZITET - UNIVERSITY
HAXHI ZEKA



RISKU AFARIST DHE RISKU I PASTËR

Kapitulli 5

Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. (c) Fisnik Morina

Mars, 2018

MENAXHIMI I RISKUT

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: Kontabilitet dhe Financa
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku, Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu , fisnik.morina@unhz.eu



Risku afarist

3

- Ky lloj i riskut është i datës relativisht të re dhe ai përfshinë të gjitha risqet kryesore me të cilat ballafaqohet një firme afariste.
- 1. Risku i pastër,
- 2. Risku spekulativ,
- 3. Risku strategjike,
- 4. Risku operativ
- 5. Risku financiar.



Risku afarist

4

- **Risku strategjik** ka të bëjë me të gjitha pasiguritë të lidhura me qëllimet financiare të firmës. Për shembull, nëse firma e dhënë vendos të nise ndonjë fushë të re të afarizmit mund të ndodhë që kjo fushë të jetë jo fitimprurëse.
- **Risku operativ** është rezultat i operacioneve afariste të firmës. Për shembull, banka që ofron lloje të reja të shërbimeve, sikurse që janë shërbimet e on-line pagesave, mund të pësoi dëm për shkak të sulmeve të hakerve në sistemin e tyre kompjuterik.
- **Risku financiar** ka të bëjë me pasigurinë në pikëpamje të dëmeve që janë pasoj e ndryshimeve të dëmshme të çmimeve të mallrave, të normave të kamatës, vlerës së valutës së jashtme, si dhe vlerës së parasë vendore.



Risku afarist

5

- **Risku afarist** po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për menaxhimin me riskun komercial, respektivisht me mënyrën në të cilën ndenjv organizatë e identifikon dhe sillet ndaj risqeve kryesore dhe të vegjël.
- Sot gjithnjë e më shumë shkohet nga ajo që menaxhimi me rrezik në ndërmarrjes të jetë një program unik për përpunimin e të gjitha rreziqeve kryesore me të cilët ballafaqohet ndonje firmë.
- Meqenëse deri me tani të gjitha risqet janë sjellë në marrëdhënie korrelacioni, kombinimi i tyre e zvogëlon rrezikun e gjithëmbarshtëm të firmës.



Llojet e riskut afarist

6



RISQET TË CILËT TEK LAJMËROHEN

7

- Për **risqet tek që lajmërohen** është karakteristike se ata në esence veç ekzistojnë, por me metoda tradicionale nuk mund të parashikohen e as të vlerësohen.
- E vetmja që dihet për ato është se mund të shkaktojnë dëme jashtëzakonisht të mëdha, respektivisht mund të jenë katasrofale.
- Për këto risqe nuk ekzistojnë të dhëna statistikore dhe nuk mund të vlerësohet probabiliteti i tyre, sepse këto janë rreziqe akumulative.
- Një nga risqet e tilla në të kaluarën ka qenë risku i azbestit pasojat e të cilit akoma ndjehen, edhe pse sot ky rrezik është i përjashtuar nga të gjitha sigurimet nga përgjegjësia.



RISQET TË CILËT TEK LAJMËROHEN

8

Sot ekzistojnë supozime mbi rreziqet e ndryshme të cilët mund ti kenë karakteristikat e këtyre rreziqeve dhe për këtë shumë bëhen hulumtime mbi ndikimin e tyre ne njerëz dhe ne ambient. Disa rreziqe qe kane karakteristikat e rrezikut nga azbesti janë:

- Materiet helmuese
- Radioaktiviteti elektromagnetike
- Rrënimi i sanksioneve tregtare dhe ekonomike
- Stresi në vendin e punës
- Nanoteknologjia
- Modifikimi gjenetik i ushqimit
- Terrorizmi
- Transplantët
- Pirja pasive e duhanit
- Ngrohja globale
- Vjedhja e identitetit
- Aktivitetet vullkanike
- Ndikimi i medieve



RISQET TË CILËT TEK LAJMËROHEN

9

- ❖ Karakteristikat themelore të risqeve që tek lajmërohen janë rreziqet të cilat dikujt tanimë i janë të njohura, mirëpo jo edhe industrisë së sigurimeve.
- ❖ Kështu që, një rrezik për tu bë i kuptueshëm dhe i dallueshëm si i tille, duhet të ekzistojnë objekte të mjaftueshme të cilët i janë nënshtruar ndikimit të ngjarjes së dhënë të dëmshme ku dëmi nuk mund të shmanget.
- ❖ Kështu që është e nevojshme që të ekzistoi punë e përbashkët ndërmjet shkencëtareve dhe ekspertëve nga industria e sigurimeve me qëllim të hulumtimit të të gjitha mundësive të zgjidhjes së problemit që i nënshtrohen rreziqet e tilla.



LLOJET E RISKUT TË PASTËR

10

Llojet kryesore të riskut të pastër, të cilët mund të krijojnë pasiguri të madhe financiare, përfshijnë:

1. Risqet personale,
2. Risqet në pasuri,
3. Risku nga përgjegjësia,
4. Risqet e ndodhura për shkak të lëshimeve të tjerëve.



RISQET PERSONALE

11

Risqet personale janë ata që drejtpërdrejtë ndikojnë në individin. Këto janë risqe që drejtpërdrejtë janë të lidhura me shëndetin dhe mirëqenien e individit e që përfshinë mundësinë e humbjes kompletë apo zvogëlimin e të ardhurave të fituara, shpenzimet ekstra si dhe dobësimin e aktivës së pasurisë.

Ekzistojnë katër rreziqe kryesore personale:

1. Rreziku nga vdekja e parakohshme,
2. Rreziku i të ardhurave të pamjaftueshme gjatë periudhës së jetës në pension,
3. Rreziku i shëndetit të keq dhe invaliditetit,
4. Rreziku nga shpenzimet medicinave,
5. Rreziku nga papunësia.



RISQET PERSONALE

12

- **Rreziku i vdekjes së parakohshme** definohet si rrezik i vdekjes së mbajtësit të familjes prapa të cilit janë detyrimet financiare.
- Këto detyrime mund të përfshijnë mbajtjen e përsoneit, huaja e papaguar, fëmijët që duhet shkolluar.
- Nëse anëtarët e mbijetuar të familjes marrin të ardhura të vogla, të ardhura nga burime tjera, apo nuk kanë burime të mjaftueshme financiare që të zëvendësojnë të ardhura që i ka realizuar kryefamiljari situata e tyre financiare është e pasigurtë.



RISQET PERSONALE

13

- ❑ Kështu që vlera e jetës njerëzore në këtë rast mund të definohet si vlerë e tanishme e pjesës së të ardhurave të ardhshme të kryefamiljarit të vdekur në të ardhurat e përgjithshme të familjes.
- ❑ Vdekja e parakohshme mund të jetë shkaktare e problemeve financiare vetëm nëse personi i vdekur ka pasur persona që i ka mbajtur apo ka vdekur me detyrime të papërmbushura financiare. Kështu, vdekja e femiut 10 vjeçar nuk është “e hershme” në kuptimin ekonomik.



RISQET PERSONALE

14

- Ky rrezik përfshinë së paku katër lloje të humbjeve, respektivisht humbjeve dhe ato:
- **Humbja e jetës njerëzore për familjen është humbje e përherëshme**, e humbur për gjithmonë dhe e pa kompenzueshme. Vlera e jetës njerëzore definohet si vlerë e tanishme e pjesëmarrjes në të ardhurat e mundshme në të ardhshmen të kryefamiljarit të vdekur në familje.
- Hapi i parë për ta përcaktuar faktin se a ekziston rreziku i humbjes së të ardhurave është vërtetimi se a do të dëmtohet dikush nga vdekja.



RISQET PERSONALE

15

- **Shpenzimet plotësuese** që mund të ndodhin për shkak të shpenzimeve të varrimit, llogarive të larta medicinale të cilat nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësore, mbulimi i huave të tjera dhe hipotekave, vërtetimit zyrtar të testamentit, përmbushja eventuale e pasivës dhe aktivës si dhe për shkak të tatimit në pronë dhe trashëgimi kur janë në pyetje sipërfaqet më të mëdha.
- **Zvogëlimi i standardit të jetës** për shkak të zvogëlimit të të ardhurave të familjes.
- **Shpenzimet jo ekonomike**, që i përbëjnë: dhimbja emocionale, humbja e modelit të rolit kryesor në familje si dhe mosekzistimi i rolit këshillues dhe personit udhëheqës për fëmijët.



RISQET PERSONALE

16

- Hulumtimet e fundit kanë treguar se shekulli mesatar i jetës së njerëzve në vitin 2001 është zgjatur dhe ka qenë 77,2 vite në raport me 77 sa ishte në vitin 2000 (77.9 për femra dhe 74,4 për meshkuj).
- Mirëpo, krahas kësaj numri i madh i njerëzve vdesin për shkak të tri sëmundjeve masive dhe atë: **sëmundjeve të zemrës, kancerit dhe sulmit në tru.**
- Risku kryesor i lidhur me moshën e shtyrë është **risku i të ardhurave të pamjaftueshme** gjatë periudhës së jetës me pension. Shumica e punëtorëve në SHBA, por edhe në vendin tonë, shkon në pension me 65 vite.



RISQET PERSONALE

17

- **Risku i lidhur për sëmundje dhe invaliditet**, i cili zakonisht manifestohet përmes paaftësisë për punë për shkak të sëmundjes së shkurtër apo afatgjatë, sëmundjeve kronike, paaftësisë afatgjatë për punë apo invaliditet, paraqet rrezik të rëndësishëm personal.
- Në rastin e këtij risku personit i janë të nevojshme të ardhurat gjatë periudhës së zgjatjes së paaftësisë për punë, e kjo veçanërisht të atyre personave që nuk kanë partner martesorë.



RISQET PERSONALE

18

- Probabiliteti i humbjes së aftësisë punuese në fazat e ndryshme të jetës është më e madhe se sa që është probabiliteti i vdekjes. Në tabelën II -7 janë dhënë vlerat për probabilitetin e vdekjes dhe të paaftësisë për punë për vitet e ndryshme të jetës.

Tabela: II -7|

Mosha	Probabiliteti i vdekjes para mbushjes se 65 vite jete (%)	Probabiliteti tremujore i pa aftësisë për punë para se te mbushe 65 vite jete (%)
25	24	54
30	23	52
35	22	50
40	21	48
45	20	44
50	18	39
55	15	32
60	9	9



RISQET PERSONALE

19

- Prej tabelës shihet se probabilitëti për paaftësi për punë ne kohëzgjatje se paku prej 3 muajve është shumë me e madhe gjatë vitëve të afta për punë të përonave të moshuar, se sa qe është probabilitëti i vdekjes. Gati gjysma e njerëzve qe i kane mbushur 35 vitë do të jene të paaftësuar se paku tre muaj para se ti mbushin 65 vitë, ndërsa gjatësia mesatare e zgjatjes se paaftësisë është me shumë se 5 vitë.
- Kjo me vetë bartë si pagesën e llogarive të mëdha medicinave gjithashtu edhe humbjen e të ardhurave. Për shembull, operacioni ne zemër të hapur kushton mbi 250.000 euro, ndërsa transplantimi i veshkave apo zemrës kushton edhe me shumë se 300.000 euro, ndërsa shpenzimet e shërimit nga fatkeqësia automobilistike të cilat kërkojnë disa operime të mëdha, kirurgjinë plastike dhe rehabilitimin mund të tejkalojnë shumën e 400.000 eurove.



RISQET PERSONALE

20

- Përveç kësaj kujdesi afatgjatë nëpër shtëpia mund të kushtoi mbi 6000 euro apo me shumë çdo vitë. Nëse personat e këtillë nuk kanë sigurim adekuat shëndetësorë, kursime personale, burimet e veta financiare (nga aksionet etj.) apo burime të tjera financiare të cilat mund ti mbulojnë këto shpenzime, atëherë të ata pasiguria financiare është e pranishme në mase të madhe.
- Shkaku i dytë kryesorë i pasigurisë financiare në rastet kur fillon sëmundje serioze është **humbja e të ardhurave**. Në rastet e invaliditetit afatgjatë humbja e të ardhurave është e madhe, faturat medicinale grumbullohen, mund të humben apo të zvogëlohen beneficet e të punësuarit, kursimet shpesh janë të vogla dhe dikush duhet ta merre kujdesin për personin e paftësuar.



RISQET PERSONALE

21

- ✓ **Risku nga papunësia** gjithashtu shumë mund të ndikoi në sigurinë financiare të personit. Papunësia mund të jetë rezultat i ngadalësimit të ciklit afarist, ndryshimeve teknologjike dhe strukturore në ekonomi, faktorëve sezonal dhe pa përsosshmërisë së tregut të punës.
- ✓ Pa marrë parasysh shkaqet, papunësia mund të jetë shkaktarë i pasigurisë financiare së paku në tri mënyra. Nëse nuk ekziston ndërrimi adekuat për të ardhurat, apo ndonjë kursim i mëhershëm e cila mund të shfrytëzohet, punëtori i papunë do të jetë financiarisht i pasigurtë. E dyta, për shkak të kushtëve ekonomike, punëtorin ndoshta do të jetë ne mundësi që të punoi me orar të shkurtë.



RREZIQET E PASURISË

22

- Të gjitha firmat dhe individët që kanë, marrin me qira apo e shfrytëzojnë ndonjë pasuri i nënshtrohen rrezikut që pasuria e tyre të pësoi dëm apo që ta humbin nga arsye të ndryshme.
- Që të analizohet në mënyrë të plotë nënshttrimi ndaj riskut të pasurisë, duhet të shqyrtohen si llojet e pasurisë të cilat mund ti nënshtrohen dëmit, gjithashtu edhe burimet potenciale të riskut të tillë.
- Burim i dëmeve nuk janë vetëm zjarret dhe tufanet, por ato mund të jenë edhe vjedhjet, vërshimet, tornado, eksplozionet, ndeshjet e komunikacionit, sendet që bien, vërshimet, tërmetët, temperaturat e ulëta etj.



RISKU NGA PËRGJEGJËSIA

23

- **Risku nga përgjegjësia** është lloji i tretë i riskut të pastër me të cilin ballafaqohen shumica e individëve.
- Sipas sistemit ligjor në shumicën e vendeve, e edhe të n, ndonjë person (person juridik apo fizik) mund të kenë përgjegjësi ligjore për dëmin i cili ka ndodhur prej veprimtarisë së tij, posedimit të sendit, prej marrëdhënies juridike apo të vetive të caktuara si burim i rrezikut, dhe ka për pasojë lëndimin e personit të tretë, apo dëmet në pasurinë që i takon personit të tretë.
- Gjykata mund të urdhëroi që të paguhet kompensim i rëndësishëm për dëmet e shkaktuara personave të tretë e cila paraqet kompensimin palës së tretë.



RISKU NGA PËRGJEGJËSIA

24

- Përveç kësaj gjykata mundet ta dënoi edhe me para personin që është përgjegjës në këtë rast. Edhe kur të vjen deri të lirimi prej përgjegjësisë shpenzimet e gjykit mund të jenë të rëndësishme.
- Kështu që është e domosdoshme që firmat dhe individët ne mënyrë të kujdesshme të identifikojnë të gjitha burimet e riskut nga përgjegjësia të cilat mund të ndikojnë të ata dhe të përgatitin aranzhime të përshtatshme për trajtimin e detyre rreziqeve.

Përgjegjësia mund të jetë pasojë e:

1. Gabimit të qëllimshëm,
2. Përgjegjësisë strikte apo absolute,
3. Moskujdesit.



RISKU NGA PËRGJEGJËSIA

25

- **Gabimi i qëllimshëm** paraqet shkelje të rregullave dhe kjo është e ashtuquajtura përgjegjësi ligjore e cila ndodhe për shkak veprimit apo lëshimit të qëllimshëm pasojë e se cilës është dëmi në pasurinë e huaj apo lëndimi i personit tjetër. Shembuj të kësaj përgjegjësie përfshinë qasja e paautorizuar në prone, mashtrimet, lëndimi i se drejtës në patente apo të drejtë të autorit etj.
- **Përgjegjësia strikte apo absolute** ka të bëjë me rastet kur rrezikshmëria potenciale për individë dhe shoqëri është aq e madhe që disa persona mund të jenë përgjegjës edhe atëherë kur nuk mund të dëshmohet qëllimi i tyre. Disa situata të zakonshme në të cilat vlenë ky lloj e përgjegjësisë përfshinë prodhimtarinë e eksplozivit, mbajtja e kafshëve të egra apo kafshëve të rrezikshme, lëndimet në punë dhe sëmundjet profesionale të të punësuarve.



RISKU NGA PËRGJEGJËSIA

26

- Sa i përket riskut të punësuarve ekzistojnë tabela statistikore të shkallës së ngjarjeve të dëmshme (SHND) në grup prej 1000 njerëzve gjatë shekullit të punës (10^8 h). Në tabelën II-7 janë dhënë të dhënat e vlerës së SHND të cilat për industrinë e caktuar janë publikuar në Britaninë e Madhe për periudhën 1974-1978.

Tabela: II – 7

	SHND	Risku për person/viti
Gazi dhe nafta	82	165×10^{-5}
Zenja e peshqve ne detet e thella	44	88×10^{-5}
Xehetaria	10	20×10^{-5}
Ndërtimtaria	7,5	$17,5 \times 10^{-5}$
Anije ndërtimtaria dhe inxhinjeringu detar	5,25	$10,5 \times 10^{-5}$
Industria kimike dhe e ngjashme	4,25	$8,5 \times 10^{-5}$
Te gjitha objektet e përfshira ne aktet e fabrikave	4	8×10^{-5}
E gjithë industria prodhuese	1,15	$2,3 \times 10^{-5}$
Prodhimi i automjeteve	0,75	$1,5 \times 10^{-5}$
Konfeksioni	0,25	$0,5 \times 10^{-5}$



RISKU NGA PËRGJEGJËSIA

27

- **Moskujdesi apo mos vëmendja** definohet si dështim qe të ofrohet kujdesi standard, respektivisht kujdesi i cili është caktuar me rregullore, e me qëllim të mbrojtjes se personave të tjerë nga rreziku i paarsyeshëm apo lëndimet.
- Mjekeve, avokatëve, kontabilistëve, inxhinierëve dhe profesionistëve tjerë gjithashtu mund të gjykohen duke u thirrur ne moskujdesin profesional dhe gjithnjë lajmërohen llojet e reja të kontëstëve gjyqësore. Qe një ngjarje të klasifikohet si moskujdese ajo duhet të përfshijë këto elementë:
 1. Ekzistimin e obligimit ligjore për ndonjë kujdes/brenge,
 2. Moskujdesinë në përmbushjen e këtij obligimi,
 3. Dëmin apo lëndimin e bartësit të kërkesës për zhdëmtim,
 4. Shkakun e drejtpërdrejtë, respektivisht lidhjen midis moskujdesit dhe dëmit të shkaktuar.



RISQET QË NDODHIN PËR SHKAK TË LËSHIMIT TË PERSONIT TJETËR

28

- Kur një person pajtohet që të kryejë shërbime për një person tjetër, ai e merr përgjegjësinë të cilën duhet edhe ta përmbushë.
- Mirëpo, nëse mospërmbushja e asaj përgjegjësie sjellë deri të dëmi financiar të këtij personi ky është rrezik i cili është pasojë e lëshimit të personave tjetër.
- Shembuj të risqeve të kësaj kategorie janë mospërmbushja e projektit ndërtimor sipas planit, apo mospërmbushja e detyrimit të pagese sipas terminit të kontraktuar.



RËNDËSIA E RISKUT PËR SHOQËRINË

29

- Rreziku më i madh që kërcënon nga ndonjë risk është që disa dëme apo humbje edhe realisht do të ndodhin. Kur digjet shtëpia nga ndonjë zjarr, apo vidhen parat, apo vdesë personi i cili fiton të ardhurat, atëherë ekziston humbje financiare.
- Nese dikush është i pakujdesshëm, dhe ai moskujdes i shkakton dëmin personit tjetër apo dëme në pasuri, sërish paraqitet humbje financiare.
- Të gjitha këto humbje apo dëme janë ngarkesë për shkak të riskut si për individin ashtu edhe për shoqërinë dhe me vet këtë janë arsye primare për shkak të cilës tentohet që risku të shmanget apo të zbuten pasojat e tij.



RËNDËSIA E RISKUT PËR SHOQËRINË

30

- Krejt kjo do të thotë se prania e riskut ka për rezultat efekte të dukshme të padëshirueshme sociale dhe ekonomike.
- Prandaj me rëndësi kyçe është që secili risk të dallohet dhe të ndërmerren të gjitha masat e mundshme për parandalimin apo zbutjen e tij. Ngarkesat që risku i krijon për shoqërinë paraqitën përmes faktorëve si vijon:
 1. Nevoja që të krijohen fondet për raste të fatkeqësive,
 2. Mosekzistimin e mallrave dhe shërbimeve të caktuara,
 3. Praninë e brengës dhe të frikës.



Ju faleminderit për vëmendje!

fisnik.morina@unhz.eu

www.unhz.eu

www.unhz.weebly.com



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"